



VENDIM

Nr. 5 , datë 30.01.2017

PËR

“MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË RROGOZHINË PËR VITIN 2017 ”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me dt.30. 01. 2017, analizoi ,diskutoi dhe mori në shqyrtim Relacionin e ardhur nga Bashkia, me shkresën Nr.231. Prot, datë 24.01.2017 “Për diskutimin dhe miratimin e projekt buxhetit të Bashkisë për vitin 2017”.

Në mbështetje të gërmës “dh” të nenit 54 ligjit Nr.139/2015, dt. 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore“Mbështetur në Ligjin nr.9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”neni 38,të nenit 19 te ligjit nr.147/2015 “per buxhetin e vitit 2016”,të Aktit normativ nr.2 dt.16.12.2016”Disa ndryshime në ligjin nr.147/2015“Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2016”,të ligjit nr.130/2016 “Për Buxhetin e vitit 2017” , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI :

Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Rrogozhinë për vitin 2017.

Si më poshtë vijon :

Në ndryshim nga viti 2016 I cili nuk ka bazë krahasuese, sepse është viti I parë që pasqyrohet nga pikëpamja strukturore dhe Financiare në zbatimin e Ligjit nr. 115/2014”Për ndarjen Administrativo – Teritoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë,viti 2017 është një vit Buxhetor më i stabilizuar dhe me tregues ekonomikë më të përshtatëshëm”

Ky vit është edhe një mundësi tjetër që nga pikëpamja e mbështetjes Buxhetore ,baza e buxhetit .pra mbulimi i shpenzimeve nga të ardhurat është më stabël në bazë të përvojës së një viti më parë,por përsëri detyra kryesore ajo e realizimit të funksionit të shërbimeve është parësore,mundësitë për Investime direkte dhe me përmasa të mëdha nuk kemi akoma.

Për vitin 2017 ka pasur një përgatitje më të hershme të Buxhetit,ku në disa takime janë diskutuar me punonjesit e njësive Vendore dhe duke qenë se një numur i konsiderueshëm relacionesh shpjeguese janë dhënë nga Sektori i Shërbimeve,për shumë tregues ekonomikë mbi të cilat është mbështetur edhe përgatitja e Buxhetit,mendojmë që për Buxhetin e vitit 2017 të japim disa shpjegime për mënyrën se ai është përgatitur.



Bazë e shpjegimeve tona do të jetë vetëm Buxheti i Pakushtëzuar pasi Buxheti i Kushtëzuar ka të bëjë me shpenzimet që realizohen në Programin 1170 "Gjendja Civile" që janë fonde të Pushtetit Lokal që varen nga Ministria e Brëndëshme dhe janë të garantuara vetëm për Artikujt 600 "Pagat" dhe 601 "Sigurimet Shoqërore" dhe për programin 10430 "Ndihma ekonomike dhe Paaftësia" që edhe këto fonde janë të garantuara nga "Ministria i Mirëqenies" por që administrohen nga ana jonë në zbatim të ligjit.

Buxheti i vitit 2017 përsëri është i përbërë në dy ndarje kryesore që janë:

- Buxheti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore dhe,
- Buxheti I Pakushtëzuar për Funkcionet e reja për vitin 2017.

Porn ë ndryshim nga viti 2016 me anë të shkresës nr.14657/2 dt.12.12.2016 nga ana e ministrisë së Financave, është edhe më i detajuar, pasi ajo që është më kryesore fondet e përdorura për funksionet shtesë janë trashëguar dhe gjithashtu është shtuar edhe një funksion tjetër kryesor që është ai i Mbrojtjes nga zjarri.

Buxheti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore përbëhet nga 18 ndarje përsa i përket shpenzimeve që janë si më poshtë:

1. 00/1110/01/600 (grupi, titulli, kapitulli, artikulli) "Paga për personelin e aparatit"
2. 00/8140/01/600 "Paga për sportin"
3. 00/8230/01/600 "Paga për Kulturën"
4. 00/1110/01/601 "Sig. Shoq dhe Shëndetës. Për personelin e Aparatit"
5. 00/8140/01/601 "Sig. Shoq. Dhe Shënd. Per sportin"
6. 00/8230/01/601 "Sig. Shoq. Dhe Shënd. Per Sektorin e Kulturës".
7. 00/1110/01/604 " Trasferta të Brëndëshme" që përfaqëson 1 % e Qarkut (1% e të Ardhurave të Planifikuara)
8. 00/1110/01/606 "Ndihma Ekonomike Nga Nësia Vendore për familjet në nevojë (3% e Buxhetit të përgjithshëm)
9. 00/1110/01/609 "Fond I emrgjencave" (rreth 2% e Buxhetit të Përgjithshëm)
10. 00/1110/01/602 "Shpenzime Operative për aparatit" ku këtu futen edhe pagat për Këshilltarët dhe Administratorët (kryepleqtë).
11. 00/8140/01/602 "Shpenzime Operative per Sportin"
12. 00/8230/01/602 "Shpenzime Operative për Kulturën"
13. 00/9120/01/602 "Shpenzime Operative për Arsimin" që ka qenë funksion edhe i mëparshëm pamvarësisht Funkcioneve të reja të Arsimit.
14. 00/6260/01/602 "Shpenzime Operative në Funkcion të Pastrimit"
15. 00/6260/01/602 "Shpenzime Operative në Funkcion të Gjelbërimit"
"Shpenzime Operative në Funkcion të Mirëmbajtjes së Varrezave"
"Shpenzime Operative në Funkcion të Dekorit të Qytetit"



16. 00/1110/01/230" Shpenzime Kapitale për Studime e Projekte" që është shumë I rëndësishëm në fazën e planifikimit të fondeve për Investime.edhe këtë vit do të kemi shumë projekte që do ti hapin rrugën në një të ardhme jo shumë të largët aktivizimit të tyre.
17. 00/1110/01/231 "Shpenzime kapitale për Rritjen e Aktiveve"
18. 00/4530/01/231 "Shpenzime Kapitale nga Fondi I Zhvillimit të Rajoneve" për pjesën e Grantit të trashëguar nga viti I kaluar.

Buxheti I Pakushtëzuar I Funksioneve të reja përbëhet nga zërat e mëposhtëm:

1. 00/9120/01/600 "Pagat e Arsimit Parashkollor Bazë"
2. 00/9120/01/601 "Sig.Shoq. dhe Shëndets. Të Arsimit Parashkollor Bazë"
3. 00/9230/01/600 "Pagat e Arsimit Parauniversitar"
4. 00/9230/01/601 "Sigurimet Shoq. Dhe Shëndetës. Të Arsimit Parauniversitar"
5. 00/4240/01/600 "Pagat e Sekt. Të Ujitjes dhe Kullimit"
6. 00/4240/01/601 "Sigurimet Shoq. Dhe Shëndets. Te Sekt. Të Ujitjes dhe Kullimit"
7. 00/4240/01/602 "Shpenzime Operative të Sektorit të Ujitjes dhe Kullimit, që janë të përcaktuara.
8. 00/4260/01/600 "Pagat e Sektorit të Administrimit të Pyjeve"
9. 00/4260/01/601 " Sigurime Shoq. Dhe Shëndets. Të Administrimit të Pyjeve"
10. 00/4260/01/602 "Shpenzime Operative të Sekt. Të Administrimit të Pyjeve.
11. 00/10910/01/600"Pagat e Sekt. Të Mbrojtjes nga Zjarri"
12. 00/10910/01/601"Sig.Shoq. dhe shënd. Të Sekt. Të Mbrojtjes nga Zjarri"
13. 00/10910/01/602"Shp.Operative të Sekt. Të Mbrojtjes nga Zjarri"

Buxheti në tërësinë e vet si kryesore ka Balancimin e tij,pra të Ardhurat të baraspeshohen me shpenzimet.

Për të Ardhurat e vitit 2017 ,kjo vetëm për Buxhetin e Pakushtëzuar të Qeverisjes Vendore, kemi 6(Gjashtë) burime.

1. Të ardhurat nga Granti I trashëguar nga viti I kaluar në shumën 985,260 lekë që përfaqëson, vlerën e trashëguar nga Fondi I Zhvillimit Të Rajoneve për vitin 2017.
2. Të ardhura të trashëguara nga granti I vitit 2016 I Min.Bujqësisë në vlerën 60,036,334 lekë për pastrimin e kanaleve.
3. Vlera e Trashëguar nga të Ardhurat e Vitit 2015 në shumën 7,168,882.58 lekë që përfaqëson shumat e pa alokuara të të Ardhurave deri ne Nëntor 2016 dhe të Ardhurat e arkëtuara në Dhjetor 2015 që transferohen ne Janar 2017.
4. Granti I Pakushtëzuar I Qeverisjes Vendore në shumën 140,778,887 lekë, I cili akoma nuk ka një specifikim të saktë në rastin e kufizimeve,por ne kemi respektuar vetëm kufizimin në fondin e pagave, 40% të Grantit është përdorur për Pagat.
5. Granti I pakushtëzuar i Ministrisë së Financave për Detyrimet e Prapambetura në shumën 20,000,000 lekë



6. Të ardhurat të Planifikuara për vitin 2017 në shumën 139,516,244 lekë, kjo pasqyrohet në planin e të Ardhurave bashkëngjitur Buxhetit.

Duke e parë Grantin do të shohim se kemi një rritje rreth 40 % më shumë se vitin e kaluar ose 44,059,345 lekë më shumë.

Për Grantet e Funksioneve shtesë kemi:

1. Të Ardhurat nga granti për vitin 2017 për Arsimin Parashkollor në shumën 25,587,000 lekë
2. Të Ardhurat nga granti për vitin 2017 për Arsimin Parauniversitar në shumën 1,857,000 lekë.
3. Të Ardhurat nga granti për vitin 2017 për Ujitjen dhe kullimin 8,787,038 lekë.
4. Të Ardhurat nga granti për Pyjet në masën 614,230 lekë.
5. Të Ardhurat nga granti për Mbrojtjen nga Zjarri në masën 10,660,000 lekë

Gjithashtu kemi të Ardhura të trashëguara nga Funksionet shtesë nga viti 2016 si më poshtë:

- Të ardhura të trashëguara nga 2016 për Arsimin Parashkollor në shumën 630,679 lekë.
- Të ardhura të trashëguara nga 2016 për Arsimin Parauniversitar në shumën 173,380 lekë
- Të ardhura të trashëguara nga 2016 për Ujitjen dhe Kullimin në shumën 499,745 lekë
- Të ardhura të trashëguara nga 2016 Për Pyjet 509,888 lekë.

Të Ardhurat:

Për të Ardhurat këtë vit kemi bazë krahasimi të plotë me vitin 2015.

Poshtë kemi një tabelë ku analizohet realizimi i të Ardhurave për muajin dhjetor 2016 dhe për vitin 2015.

Gjatë periudhës

Janar - Dhjetor 2016

Nr.	Emërtimi	Nr. Llogarise	Janar - Dhjetor Fakti 2016	Janar - Dhjetor Plani 2016	realiz. ne %	diferenca nga vjetori
1	Takse Biznesi Vogel	7002200	1998685.00	10175000.00	19.64	-8176315.00
2	Takse tokes bujqesore	7020100	22294991.00	20962166.00	106.36	1332825.00
3	Takse Ndertese	7020200	10581967.00	14270000.00	74.16	-3688033.00
4	Takse kalim pronesie	7029200	55946.69	510000.00	10.97	-454053.31
5	rregjistr. Vjetor I automj.	7033001	0.00	0.00	0.00	0.00
6	takse rregj.biznesi	7035001	90000.00	240000.00	37.50	-150000.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



7	Takse tregu	7035002	9620000.00	3817044.00	252.03	5802956.00
8	leje ndertimi Kkrtr	7035003	6446680.00	25000000.00	25.79	-18553320.00
9	Takse Gjuetie	7035004	2000.00	0.00	0.00	2000.00
10	Takse fjetje ne hotel	7035005	2555700.00	2725016.00	93.79	-169316.00
11	Takse reklame	7035008	929680.00	2200000.00	42.26	-1270320.00
12	Takse tablele	7035009	1714395.00	2137500.00	80.21	-423105.00
13	Te tjera taksa tarifa	7035099	92000.00	200000.00	46.00	-108000.00
14	takse akti dhe pulle	7081006	130000.00	0.00	0.00	130000.00
15	Takse trualli	7109200	270060.00	250000.00	108.02	20060.00
16	Qera	7109600	4800.00	0.00	0.00	4800.00
17	tarife akte administrativ	7110105	23100.00	233000.00	9.91	-209900.00
18	Leje transporti	7110106	1365215.00	76500.00	1784.59	1288715.00
19	Takse pastrimi	7110501	8545910.00	5791615.00	147.56	2754295.00
20	kontrib.miremb.rruge	7110502	222900.00	0.00	0.00	222900.00
21	Leje banimi	7110504	14100.00	0.00	0.00	14100.00
22	Tarifa rregullatore	7110599	2374886.00	552000.00	0.00	1822886.00
23	te Ardh.nga kopshtet	7111001	0.00	0.00	0.00	0.00
24	Takse parkimi	7111007	128710.00	116400.00	110.58	12310.00
25	Shitje prod.bujq.pyjore	7113001	150000.00	0.00	0.00	150000.00
26	Gjoba	7115499	451489.00	0.00	0.00	451489.00
27	gjoba nga sistemi tat.	7115001	20000.00	0.00	0.00	20000.00
28	Takse rregjistrim automjeti	7201101	3179566.00	0.00	0.00	3179566.00
29	te tjera		0.00	75675384.00	0.00	-75675384.00
						0.00
	Gjithsej		73262780.69	164931625.00	44.42	-91668844.31

Janar dhjetor
2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



Emërtimi	Nr. Llogarise	Dhjetor Fakti 2015	Shuma	realiz. ne
			Totale Plani	%
Takse Biznesi Vogel	7002200	292572.00	13511758	77.11
Takse tokes bujqesore	7020100	3891618.00	29817848	70.30
Taks Ndertese	7020200	1531063.00	15086650	90.24
Takse kalim pronesie	7029200	0.00	700000	21.79
rregjistr. Vjetor I automj.	7033001	20000.00	200000	16.16
takse rregj.biznesi	7035001	10000.00	390000	61.54
Taks tregu	7035002	211000.00	4660000	94.08
jeje ndertimi Kkrrt	7035003	0.00	11100000	46.81
Takse fjetje ne hotel	7035005	36000.00	2000000	104.60
Taks reklame	7035008	0.00	814751	64.27
Taks tabele	7035009	25140.00	360760	80.10
takse akti dhe pulle	7081006	50000.00	0	0.00
Qera	7109600	0.00		0.00
tarife akte administrativ	7110105	2300.00	289920	39.39
Leje transporti	7110106	10100.00	3063600	22.67
Taks pastrimi	7110501	402230.00	12180263	48.65
Leje banimi	7110504	0.00		0.00
Tarifa rregullatore	7110599	411880.00	0	0.00
te Ardh.nga kopshtet	7111001	0.00	0	0.00
Taks parkimi	7111007	16300.00	260000	58.38
Gjoba	7115499	0.00	0	0.00
Taks rregjistrim automjeti	7201101	234123.00	2000000	161.57
te tjera		0.00	173800	4488.27
				0.00



Gjithsej		71443260.00	96609350.00	87.46
----------	--	-------------	-------------	-------

Duke bërë analizën e vitit 2016 arrijmë në konkluzionin që realizimi është në masë shumë të ulët pra rreth 44.4 % dhe në vlerë Absolute nga 164,931,625 lekë të planifikuara janë realizur 73,262,781 lekë. Edhe në mbledhjen e muajin Nëntor 2016 kur diskutuam të dhënat e treguesve ekonomikë për 9-mujorin ne e ngritëm këtë problem dhe shumica e Këshilltarëve e kanë të qartë, por duhet ta theksojmë përsëri sepse është shumë e rëndësishme.

Po të zhveshim nga plani i përgjithshëm i të Ardhurave, planifikimin e parashikuar për tre treguesit që ndikuan ndjeshëm në mosrealizim ato janë:

- Planifikimi i taksës së shfrytëzimit të Karburanteve me rreth 30 milion lekë. e cila nuk u realizua për arsye se tregëtarët e karburanteve e kishin më parë leje shfrytëzimi, që ne nuk e kishim shumë të qartë, pas shkrirjes së ish-Komunave.
- Planifikimi i Lejeve të ndërtimit në masën rreth 50 milion lekë. e cila është shpjeguar me mosfunksionimin akoma të Ligjit për lejet e Ndërtimit.
- Parashikimi i Rentës minerare prej rreth 3 milion lekë, edhe kjo nuk u realizua për shkak të mosfunksionimit të ligjit për rentën minerare.
- Gjithashtu një faktor tjetër që është shumë i rëndësishëm për tu theksuar është edhe "Taksa e Biznesit" e cila është planifikuar e njëjtë me atë të vitit 2015, dhe që duhej të mblidhej nga administrata Qëndrore e Tatim Tasksave, edhe kjo nuk u realizua për këtë arsye dhe u realizua vetëm në masën 20% duke lënë një vlerë absolute porealizuar rreth 8.2 milion lekë.

Duke e parë në këtë këndvështrim realizimi prej 44.4 % nuk tregon realitetin dhe ajo që është kryesore po ta krahasojmë me të njëjtën periudhë të vitit 2015 realizimi është rreth 3% më i madh në vlerë absolute, viti 2016 73.3 milion lekë dhe viti 2015 71.4 milion lekë.

Në realizimin e vitit 2015 kanë ndikuar edhe disa të ardhura të trashëguara nga vitet e kaluara kështu që realizimi në vitin 2016 i të Ardhurave pamvarësisht shifrave është realizuar në mënyrë të kënaqëshme.

Po të analizojmë me kujdes të dyja tabelat, shohim qartë se realizimi i të ardhurave është realizuar në masën 87.5 % për vitin 2015 dhe 44.4 % për vitin 2016, që do të thotë se në përqindje kemi një pamje joreale ndërsa në vlerë absolute ka një realizim 1.8 milion lekë më shumë në vitin 2016.

Ndërsa për të analizuar punën e Sektorit të Tatimeve, në përgjithësi nuk është punuar mirë për vitin 2016 dhe shuma që mungon në Buxhet, për Sektorin e Tatimeve është rreth 91.7 milion lekë por që duke e analizuar me treguesit që thamë më lartë kjo shifër është rreth 20 milion lekë.



Në muajin Nëntor të viti 2016 duke parë se gjendja në këtë sektor ishte jo shumë e mirë është ngritur një grup pune i cili ka në përbërje të vet specialistë të fushës dhe nëpërmjet kalimit në vend për cdo subjekt nga ana e këtij komisioni i cili mban edhe nja procesverbal Konstatimi për cdo rast mendojmë se do të përmirësojë punën në të ardhmen.

Ndërsa për disa zëra që janë realizuar në masë shumë të ulët “taksa e kalimit të Pronësisë” 10.97 % , “ T.rregjistrimit të Bizneseve” 37.5 % ,”Tarife e akteve Administrativë” 9.91% janë taksa që edhe janë planifikuar gabim por edhe realizimi i tyre nuk varet nga Institucioni jonë.

Gjithashtu kemi taksa që janë realizuar shumë mbi 100 % si “Taksa e rregj. Të Automjeteve” që ska psur planifikim fare sepse përcaktohet nga Zyra e Rregjistrimit të Automjeteve.”Leje transporti” 1785% kjo taksë vjen si pasojë e rregullave që janë vendosur nga Qrkullimi i Mallrave dhe mjeteve,dhe taksa e pastrimit ne masën 148 % vjen si pasojë e rritjes së taksës së sip. Së tokës në shfrytëzim nga biznesi,me qëllimgoditjen e fenomenit të braktisjes së ndertimeve.

Planifikimi i të Ardhurave për vitin 2016 është në masën 139,742,386 (njëqindetridjetenententëmilion e shtateqindedyzetedymije treqindetetedhjetëegjashtë) lekë.

Pra kemi një ulje me 25,415,381 lekë nga viti i kaluar ose një rritje prej 15.3 %.Në konsultim me Degën e Tatim Taksave kjo ulje ka 3 (tre) zëra më kryesore:

- Taksa e Shfrytëzimit të karburanteve që parashikohet edhe këtë vit të mos planifikohet e saktë sepse është për shqyrtim në gjykatë. Në shumën rreth 20 milion lekë.
- Taksa e Rentës minerare.Kjo taksë llogaritet si shumë e Rentës Minerare të Kostove vjetore të shfrytëzimit të lëndëve minerare(rërë, zhavorre) që është 5%. Pesëdhjetë % e kësaj shume i takon Pushtetit Vendor nga ana e Drejtorisë së Tatimeve.në shumën rreth 3 milion lekë
- Taksa e lejes së shfrytëzimit të objekteve të ndërtimit e cila edhe këtë vit nuk mund të parashikohet e saktë,për arsye se akoma nuk është implementuar ligji.kjo shumë që ulet llogaritet me rreth 10 milionë lekë.

Të tre këta tregues ulin të ardhurat me 25 – 35 milion lekë në vit.

Ndërsa po të flasim për treguesit e tjerë ata janë në nivelin e sotëm dhe me rritjen që do të ketë për efekt të mosrealizimeve të vitit 2016 dhe të një përqindje rritjeje që ne kemi llogaritur për efekt të shtesave që do të kemi në bizneset e reja.

Për realizimin e të ardhurave Mund të komentojmë si më poshtë realizimin për cdo njësi Administrative.

Vlerësime për njësitë Administrative duke marrë pjesën më të madhe të treguesëve për 9-mujorin e vitit 2016 janë si më poshtë:

Për njësinë administrative Sinaballaj.



- Taksa e tokës bujqësore 740 000 lekë plani 916 000 lekë fakti, realiz. 124%
 - Taksa e ndërtesës 130 000 lekë plani 180 000 lekë fakti, realiz. 138 %
 - Taksa e pastrimit 50 000 lekë plani 45 000 lekë fakti, realiz, 90%
 - Taksa e reklamës 50000 lekë plani 30 000 lekë fakti, realiz. 60%
 - Qera toke 100 000 lekë plani 107 000 lekë fakti , realiz. 107%
 - Taksë biznesi 130 000 lekë plani 142 000 lekë fakti realizimi 109%
- Totali 1 200 000 lekë plani 1 420 000 lekë fakti realizimi 118%
-

Realizimi i të ardhurave për këtë njësi është i parëndësishëm edhe pse është e lartë përqindja e realizimit.

Për njësinë administrative Kryevidh.

- Taksa e tokës bujqësore 8 000 000 lekë plani 8,889,110 lekë fakti, realiz. 111%
 - Taksa e ndërtesës 3 200 000 lekë plani 2,310,620 lekë fakti, realiz. 72.3 %
 - Taksa e fjetjes hotel 2 000 000 lekë plani 2 700 100 lekë fakti, realiz, 135%
 - Taksa e Pastrimit 1 650 000 lekë plani 2,670,700 lekë fakti, realiz. 161%
 - Tarifë mirëmb. varreza 550 000 lekë plani 518,700 lekë fakti , realiz. 31%
 - Taksë biznesi 1 190 000 lekë plani 107 300 lekë fakti realizimi 10.8%
- Totali 14,870, 000 lekë plani 18 002 895 lekë fakti realizimi 121.1%
-

Njësia vendore kryevidh duhet lavdëruar si përherë për realizimin e të Ardhurave, gjithashtu edhe plani i tyre në vlerë absolute ndikon drejtëpërdrejt në realizimin e shpenzimeve, por duhet thënë se duke e parë realizimin e planit të të ardhurave nga Biznesi i vogël edhe këtu ka probleme.

Për njësinë administrative Lekaj.

- Taksa e tokës bujqësore 5 500 000 lekë plani 6,126,000 lekë fakti, realiz. 111.4%
 - Taksa e ndërtesës 2 670 000 lekë plani 2,666,000 lekë fakti, realiz. 99.8 %
 - Taksa e pastrimit 1 360 000 lekë plani 1 049 000 lekë fakti, realiz, 76.8%
 - Taksa e reklamës 100 000 lekë plani 49,000 lekë fakti, realiz. 49 %
 - Mirëmbajtje varrezash 390 000 lekë plani 223,000 lekë fakti , realiz. 57. %
 - Taksa Të tjera 1 170 000 lekë plani 1 252 747 lekë fakti realizimi 107.1%
- Totali 10,570 000 lekë plani 10,416.000 lekë fakti realizimi 99. %
-

Përveç dy treguesve që janë pak problematikë njësia vendore Lekaj paraqitet mirë në realizimin e treguesve të të Ardhurave.

Për njësinë administrative Gosë.

- Taksa e tokës bujqësore 5,337,380 lekë plani 4,318,976 lekë fakti, realiz. 80..8%
- Taksa e ndërtesës 2,168,400 lekë plani 1,012,200 lekë fakti, realiz. 50 %
- Taksa e pastrimit 1 430 000 lekë plani 821,200 lekë fakti, realiz, 57 %



- Taksa e reklamës 200 000 lekë plani 40 500 lekë fakti, realiz. 20 %
 - Haps. Publike 114,000 lekë plani 86 400 lekë fakti , realiz. 76%
 - Taksë fjetjes ne hotel 13 000 lekë plani 12 600 lekë fakti realizimi 10%
 - Të tjera taksa 2,286,000 lekë plani 784,380 lekë fakti , realizimi 34 %
- Totali 11,548,780 lekë plani 7,076,256 lekë fakti realizimi 61%

Njësia Administrative Gosë është dicka më dobët.

Duke i analizuar në përgjithësi të pesta njësitë tek njësia qendër janë edhe mosrealizimet më të mëdha por që janë për arsye të tre treguesve që thamë më sipër, ku dy tregues paraqiten me realizim 0 dhe tjetri me realizim vetëm 10%.

Analiza e realizimit të Shpenzimeve Kapitale.

Pasqyra e Investimeve.

Janar - Dhjetor

Pasqyra nr 2 Investime.

2016

Investime per vitin 2016 sipas burimeve te financimit.

000/leke

Nr.	EMERTIMI	MJESIA MATJES	TREMUIJORI IV- tert		PREJ FILLIMIT TE VITIT	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt
	INVESTIME GJITHSEJ	000/leke	174035	114858	174035	114858
A	Buxheti I Shtetit	000/leke	104558	103240	104558	103240
1	toka troje terrene,rruge	000/leke	94948	93963	94948	93963
2	Ndertesa	000/leke	9610	9277	9610	9277
B	Mjetet e Veta	000/leke	69477	11618	69477	11618
1	toka troje terrene	000/leke	24771	2250	24771	2250
2	Ndertesa	000/leke				
3	Ndertime dhe Instalime te Pergj.	000/leke	8551		8551	
4	Instalime teknike makineri paisje	000/leke	8055	1895	8055	1895



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



9	Paisje zyre dhe informatike	000/leke	2100	2503	2100	2503	
10	Studime Projektme	000/leke	26000	4970	26000	4970	
C.	Financime te Huaja	000/leke	0	0	0	0	

Pasqyra nr 2 Investime.

Investime per vitin 2015 sipas burimeve te financimit.

000/leke

Nr.	EMERTIMI	MJESIA MATJES	TREMUJORI IV- tert		PREJ FILLIMIT TE VITIT	
			Plan	Fakt	Plan	Fakt
	INVESTIME GJITHSEJ	000/leke	21055	20640	23655	20640
A	Buxheti I Shtetit	000/leke	14304	13991	16904	13991
1	toka troje terrene,rruge	000/leke	12391	12107	14991	12107
2	Ndertesa	000/leke	1884	1884	1884	1884
3	Ndertime dhe Instalime te Pergj.	000/leke	29	0	29	0
B	Mjetet e Veta	000/leke	6751	6649	6751	6649
1	toka troje terrene	000/leke				
2	Ndertesa	000/leke	2657	2527	2657	2527
5	Orendi	000/leke	700	691	700	691
6	paisje per sigurim energjie	000/leke	850	835	850	835
7	paisje per mbrojtje k. zjarrit	000/leke	700	697	700	697
8	Mjete transoprti	000/leke				
9	Paisje zyre dhe informatike	000/leke	800	855	800	855
10	Studime Projektme	000/leke	1044	1044	1044	1044
C.	Financime te Huaja	000/leke	0	0	0	0



Pasqyra e Investimeve.

Duke I krahasuar me një viti më parë Shpenzimet kapitale janë rritur me 10 herë .

Dhe pot ë shikojmë tabelën e mëposhtëme do të shohim realizimin e dy viteve të fundit.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2015	Viti 2016	Rritja në %
A	Buxheti I Shtetit	13,991	160,533	11 herë
1	toka troje terrene,rruge	12,107	151,256	12 herë
2	Ndertesa	1,884	9,277	5 herë
3	Ndertime dhe Instalime te Pergj.	0	0	
B	Mjetet e Veta	1044	11,618	11 herë.
1	toka troje terrene		2,250	0
2	Ndertesa		0	
3	Ndertime dhe Instalime te Pergj.		1,895	0
4	Instalime teknike makineri paisje		0	0
5	Paisje zyre dhe informatike		2,503	
6	Studime Projektme	1044	4,970	5 herë

Duke I krahasuar shifrat e mësipërme nxjerrim konkluzionin se në total shpenzimet e planifikuara nga Buxheti I shtetit janë rritur 8 herë më shumë se një vit më parë,që tregon se janë bërë përpjekje me Instutucionet përkatëse ,edhe në rrugë Individuale për rritjen e tyre dhe ajo që është kryesorja Realizimi është më I madh se planifikimi krahasuar me dy vitet.që do të thotë se edhe në planifikim kemi qenë më dobët se ky vit.

Pjesa që ndikon më shumë dhe që mund të quhet një Investim I kryer por që nuk është paguar është investimi prej 26 milion lekë për Studime dhe projektme të Planit të përgjithshëm rregullues që është paraqitur para nesh.

Shpenzimet.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2016 janë analizuar në Tabelën e mëposhtëme por sic e thamë edhe më sipër këtë vit ato kanë një bazë të qartë krahasimi.

Tabela e mëposhtëme tregon realizimin në % për dy vite kjo sa për informacion të këshilltarëve sepse për të dy vitet shpenzimet janë realizuar pothuajse në masën 100 % në shumicën e treguesve..



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



Nr	Emërtimi i artikullit të shpenzimeve	Viti 2015			Viti 2016		
		Plani	Plani	Real %	Plani	Fakti	Real %
	Aparati						
1	Paga (600)	32392	32392	98.20	57886	57880	99.99
2	Sig.Shoq (601)	5646	5646	98.20	10435	10325	99.95
3	Shp.oper. (602)	26006	26006	98.64	25899	25841	99.78
4	Projekte (230)	1044	1044	100	4970	4970	100
5	Investim (231)	5707	5707	100.0	10955	6648	60.68
6	Investim nga F.Zhvillimit	12391	12391	97.71	74985	74000	98.69
	Investim nga F.Zhvillimit Ujesj.				19963	19963	100,00
	Invest. Nga Min. e Bujqësisë				117319	57293	48.88
9	Investim Min Mirëqenies	1879	1879	100.0	9610	9277	100.0
8	Nd.ek.inv,(606+604)	92981	92981	87.72	123780	123780	100.00
10	Qark (604) + Keshilltaret	723	723	72.00	2452	2401	97.92
11	Sherbimet Publike	21541	21541	99.78	29594	29538	98.81
12	KQZ	2099	2099	99.67	0	0	0
	Kultura	0	0		0	0	0
1	Paga (600)	774	774	97.67	677	677	100.00
2	Sig.Shoq (601)	108	108	99.00	113	113	100.00
3	Shp.oper. (602)	1165	1165	100.0	386	373	96.63
	Sporti	0	0	0	0	0	0
1	Paga (600)	326	326	100	314	314	100.00
2	Sig.Shoq (601)	49	49	100	51	51	100.00



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



3	Shp.oper. (602)	7700	7700	99.35	12147	12147	100.00
	Arsimi	11973	11973	99.84	21013	20996	99.84
	Gjendja Civile	0	0	0	0	0	0
1	Sig.Shoq (600)	1648	1648	90.35	2764	2572	93.05
2	Shp.oper. (601)	276	276	89.85	463	412	88.58
3	606- Shpenzime lindje	2800	2800	100.0	800	800	100.0
	TOTALI	229228	229228	94.8	517536	451329	87.21

Analiza lihet vetë në dorë të Këshilltarëve që ata ta interpretojnë n.q.s do të duan të kenë sqarime për shpenzimet.

Ndërsa për planifikim e shpenzimeve për të gjithë sektorët është bashkëpunura me Sektorin e Shërbimeve dhe janë analizuar në hollësi të gjitha detajet.

Është punuar me të gjitha Njësitë Administrative për nëvojat që ato kanë për mallra produkte dhe materiale dhe janë parë edhe mundësitë e realizimit nga ana e Bashkisë duke marrë dhe analizuar të gjitha kërkesat.

Më pas janë hartuar preventiva shpenzimesh për të gjitha llojet e produkteve dhe mallrave dhe janë hartuar pasqyra reale mbi bazën e të cilave është paraqitur në Buxhet ,bashkëngjitur këtij Relacioni.

Shpenzimet krahasuar me një vit më parë janë dyfishuar,dhe treguesit më kryesorë që mund të analizohen janë:

- Pagat për aparatën janë rritur me 78 % që do të thotë se janë rritur edhe pagat e punonjësve duke afuara nivelin e pagës më të ukët me pagën më të lartë sipas K.M dhe në vlerë absolute 25.5 milion lekë.
- Gjithashtu është rritur me të njëjtin nivel edhe sig.Shoq.
- Është ulur niveli i shpenz.Operative për aparatën me rreth 10 % ose në vlerë absolute me 165 mijë lekë.
- Janë rritur Investimet për projekte rreth 4-5 herë nga 1.044 njëmilion e dyzetekatërmijë lekë në 5 milion lekë.
- Është rritur gati me 16% Fondi i Investimeve për paisje elektrike,Kompjuterike dhe paisje të tjera në krahasim me vitin 2015.
- Është rritur gati 6 herë Fondi i zhvillimit të Rajoneve nga 12,391 dymmbëdhjetëmilion e treqindenëntëdhjetëmijë në 74 milion lekë.
- Nga Fondet Për Ujësllësin janë marrë rreth 20 milion lekë Investime.



- Për herë të parë është marrë fond nga Min. E Bujqësisë për Kanalet Ujitëse në vlerën 117 milion lekë dhe deri tani janë shpenzuar vetëm 57.3 milion lekë pjesa tjetër është trashëguar për vitin 2017 dhe do të shpenzohet brenda 6-mijorit të parë.
- Nga Min. E mirëqenies në ndihmë të familjeve rome është rritur gati 5 herë fondi për banesa sociale në krahasim me 2016. Nga rreth 2 milion në vitin 2015 në 9.2 milion në 2016.
- Është rritur fondi i shpenzimeve operative për Shërbimet Publike që është edhe një nga Funksonet tona bazë, me rreth 37 % ose në vlerë absolute nga 21.5 milion lekë në 29.5 milion lekë ,me 8 milion lekë më shumë.
- Janë rritur në mënyrë të ndjeshme shpenzimet Operative për Sportin gati 2 herë. Nga 7.7 milion lekë në 12.2 milion lekë në vitin 2016,me 4.5 milion lekë më shumë.
- Janë rritur gati me 2 herë shpenzimet Operative për Arsimin nga 12.milion lekë në vitin 2015 në 21 milion lekë në vitin 2016. Gati 9 milion lekë më shumë.

Ne mendojmë se në hartimin e Buxhetit 2016 janë të sintetizuara disa nga detyrat kryesore Bazë të Funksonimit të Pushtetit Vendor që është shërbimi ndaj Komunitetit.Edhe shtimi i numrit të punonjësve ka patur qëllimin e vetëm uljen e nivelit të varfërisë si dhe duke mos pasur mundësi objektive për investime direkte ,pasi kërkohen shuma të mëdha dhe ne nuk i disponojmë.

Gjithashtu rritja e fondit rezrvë me disa herë për të mbajtur në gadishmëri forca e mjete në dispozicion të emergjencave.

Këtu vlen të përmendet se Fondi i Pagave për vitin 2016,është në vlerë absolute më i vogël se Fondi i Pagave planifikuar për vitin 2015 gjithashtu edhe fondi për Sigurimet Shoqërore.

I detajuar Buxheti Për vitin 2016 paraqitet si më poshtë:

Buxheti total i të Ardhurave është si më poshtë:

1. të ardhura nga granti i vitit 2015.....66,284,393.48 lekë
2. të ardhura të trashëguara nga viti i kaluar.....7 ,187,796.16 lekë
3. të ardhura nga Granti i Pakushtëzuar.....188, 284, 155.00 lekë
4. Të Ardhura nga Granti i Pakushtëzuar i Min.Fin.....20,000,000.00 lekë
5. të ardhura Planifikuar viti 2016.....139,516, 244.36 lekë

TOTALI

421,272,589.00 lekë

Buxheti total për sa i përket Shpenzimeve është si më poshtë:

- 1 Fondi i pagave për Aparatin.....70,189,296 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK



2. Fondi i pagave për Sportin.....	2,628,000.00 lekë
3. Fondi i pagave për Kulturën.....	5,640,000 .00 lekë
4 Fondi i Sig.Shoq.Shend Aparatin	10,920,000.00 lekë
5 Fondi i Sig.Shoq.Shend Sportin	439,020 .00 lekë
6 Fondi i Sig.Shoq.Shend Kulturën	1,142,280.00 lekë
7 Fondi i Qarkut 1%.....	..730,008.00 lekë
8 Fondi për nd.Ekon. me Vend.Këshilli.....	6,138,914.00 lekë
9 Fondi Emergjencave.....	8,289,200.00 lekë
10 Fondi i Shp.Operative Aparati.....	32,172,594.00 lekë
11 Fondi i Shp.Operative Kultura.....	1,854,800.00 lekë
12 Fondi i Shp.Operative Sporti.....	17,895,300.00 lekë
13 Fondi i Shp.Operative Arsimit.....	27,661,900.00 lekë
14 Fondi i Shp.Op.Pastrim	30,907,751.00 lekë
15 Fondi i Shp.Op. Gjelberim.....	11,938,813.00 lekë
16 Fondi për studime e projekte.....	21,948,200 .00 lekë
17 Fondi për Investime e Paisje.....	60,424,451.00 lekë
18. Fonde për inv.Nga F.Zhv.Rajoneve.....	985,260.00 lekë
19.Fonde per investime per miremb. Kalesh.....	60,036,334.00 lekë
TOTALI:.....	371,942,121.00 lekë

Më poshtë po paraqesim edhe Buxhetet për Funkcionet Shtesë.

-Granti për Arsimin ParaUniversitar programi 92302,030,380.00 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....1,704,284.00 lekë
2. Sigurimet Shoqerore.....326,096.00 lekë



-Granti për Arsimin Parashkollor programi 9120.....26,217,679.00 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....22,374,917.00 lekë
2. Sigurimet Shoqerore.....3,842,762.00 lekë.

-Granti për Administrimin e Pyjeve programi 4260.....1,125,288.00 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....896,835.00 lekë
2. Sigurimet Shoqerore.....157,915.00 lekë
3. Shpenzime Operative..... 70,538.00 lekë

-Granti për Ujitjen dhe Kullimin programi 4240.....9,297,121.00 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....1,558,759.00 lekë
2. Sigurimet Shoqerore..... 267,129.00 lekë
3. Shpenzimet Operative.....7,471,233.00 lekë

-Granti për Mbrojtjen nga zjarri dhe Shpëtimi program 10910.....10,660,000.00 lekë

-Shpenzimet:

1. Pagat.....8,260,000.00 lekë
2. Sigurimet Shoqerore.....1,400,000.00 lekë
3. Shpenzimet Operative.....1,000,000.00 lekë

Gjithsej shuma për shpenzimet nga Funksonet shtesë 49,330,468.00 lekë

Dhe në total Fondi i Shpenzimeve 421,272,589 lekë i cili balancohet me të Ardhurat.

**Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 neni 54 pika “dh”, ku Thuhet se Këshilli “miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij. Në vendimin për miratimin e buxhetit miraton, gjithashtu, edhe numrin e maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë;
Përcaktojmë edhe nr. e punonjësve si më poshtë:**

Numri I punonjësve për vitin 2017



1. Bashkia qendër.....	99 (nëntëdhjetë e nëntë)
2. Punonjës me kontratë	88 (tetëdhjetë e tetë)
3. Njësia Vendore Lekaj.....	9 (nëntë)
4. Njësia Vendore Kryevindh.....	10 (dhjetë)
5. Njësia Vendore Gosë.....	10 (dhjetë)
6. Njësia Vendore Sinaballaj.....	5(pesë)
7. Arsimi Parashkollor.....	40 (dyzet)
8. Arsimi Parauniversitar.....	4(katër)
9. Administrimi I Pyjeve.....	1 (një)
10. Ujitja dhe Kullimi.....	2 (Dy)
11. Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi.....	14 (Katërbëdhjetë)
12. Qendra Komb. E Biznesit.....	1 (një)
13. Këshilltarë.....	21 (njëzet e një)
14. Administratorë.....	40 (dyzet)

Në total 344 (sipas Tabelës së Pagave)

Bashkengjitur këtij Vendimi do të gjeni edhe tabelat si me poshte:

- Tabellen e Buxhetit te Pergjithshem
- Tabellen e Buxhetit për të Ardhurat.....Tab.1
- Tabela e planifikimit te Pagave dhe nr. Punonjësve Tab. nr.2
- Tabela e Analizes se Shpenzimeve sipas Buxhetit tab nr.7/1
- Tabela e Analizes se Shpenzimeve sipa Drejtorive dhe Sektoreve tab nr.7
- Tabelat për Investimettabela nr.3

Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohen të gjithë Drejtoritë dhe zyrat e Bashkisë Rrogozhinë dhe Institucionet në varësi të saj.

Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor të Prefektit të Qarkut Tiranë.

**Kryetari Këshillit
Lutfi KASHARI**